



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 7 nëntor 2014
Nr. ref.:RK722/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI113/14

Parashtrues

Albion Sherifi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Urdhëresës së Kryetarit të Komunës së Ferizajt,
të 30 prillit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Albion Sherifi, me vendbanim në Ferizaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

2. Parashtruesi i kërkesës deklaroi se ai është drejtor ekzekutiv i OJQ-së “Nisma për Aktivizim” nga Ferizaj.
3. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk e ka specifikuar nëse e ka dorëzuar kërkesën në emër të tij apo duke vepruar si përfaqësues i OJQ-së “Nisma për Aktivizim”.

Vendimi i kontestuar

4. Parashtruesi i kërkesës e kontestoi Urdhëresën e Kryetarit të Komunës së Ferizajt të 30 prillit 2014, me të cilin të gjitha ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari tregtare, shërbime dhe aktivitete tjera në Komunën e Ferizajt u ishte ndaluar të punojnë gjatë festës zyrtare të 1 Majit.

Objekti i çështjes

5. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Urdhëresës së kontestuar, e cila pretendohet të ketë shkelur nenin 10 [Ekonomia], nenin 49 [E Drejta e Punës] dhe nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit IX [Marrëdhëniet Ekonomike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 4 korrik 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 16 korrik 2014, Ndërmarrja *Scan Color* JYSK dorëzoi dokumente shtesë lidhur me Urdhëresën e kontestuar. Këto dokumente ishin dorëzuar me njohuri të parashtruesit të kërkesës dhe i referohen gjobës monetare të shqiptuar nga Inspektorati i Tregut të Ferizajt, si rezultat i afarizmit dhe aktiviteteve tregtare të kësaj ndërmarrjeje gjatë festës zyrtare më 1 Maj.
9. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
10. Më 22 gusht 2014, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Kryetarit të Komunës së Ferizajt.
11. Më 16 shtator 2014, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues.

12. Më 21 tetor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 30 prill 2014, Kryetari i Komunës së Ferizajt nxori urdhëresën si në vijim.

“Në bazë të nenit 13, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L/040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 51, paragrafi 2. 1, të Statutit të Komunës së Ferizajt, Kryetari i Komunës me datë 30.04.2014 miratoj:

Urdhëresë për ndalimin e punës për festën e një majit

I. URDHËROHEN të gjitha ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari tregtare, shërbyese dhe veprimtari tjera që mos të punojnë për festën e një majit me datën 01.05.2014.

II. MBIKQYRJEN e kësaj urdhërese e bëjnë Inspektorët e tregut dhe Inspektori Komunal.

III. MOSZBATIMI i kësaj urdhërese nga ana e titullarëve, paraqet shkelje dhe sanksionohet me ligj.

*Kryetari i Komunës,
[...]*

14. Kjo urdhëresë ishte publikuar në ueb-faqen e Komunës së Ferizajt.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Siç u theksua më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Urdhëresa e Kryetarit të Komunës së Ferizajt ka shkelur nenin 10 [Ekonomia], nenin 49 [E Drejta e Punës] dhe nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit IX [Marrëdhëniet Ekonomike] të Kushtetutës.
16. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon se “Një urdhëresë e tillë shkel të drejtat individuale të qytetarëve të komunës së Ferizajt nga një autoritet publik siç është Komuna e Ferizajt, përkatësisht të Drejtën e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit e garantuar me nenin (49) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe paraqet ndërhyrje të shtetit në ekonominë e tregut të lirë që është një parim qenësor i funksionimit demokratik të institucioneve publike në Republikën e Kosovës”.
17. Parashtruesi kërkon “[...] që Gjykata të gjej që vendimi dhe veprimi i Kryetarit të Komunës është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe rendin kushtetues të Republikës në mënyrë që të mbrohen parimet themeltare të shtetit tonë, që garantojnë të drejtën e punës dhe ekonominë e bazuar në tregun e lirë[...]

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:
 1. *Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
(...)
 7. *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*
20. Gjykata i referohet edhe nenit 47 të Ligjit, i cili parasheh:
 1. *Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
21. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:
 - (3) *Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*
(...)
 - (c) *kërkesa parashtrohet nga një palë e paautorizuar;*
22. Gjykata rikujton se parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Urdhëresës së Kryetarit të Komunës së Ferizajt, të 30 prillit 2014.
23. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk pretendon dhe nuk dëshmon se të drejtat dhe liritë e tij ishin ose janë shkelur drejtpërdrejt nga ai autoritet publik.
24. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se Kushtetuta nuk parasheh ngritjen e një "actio popularis", gjegjësisht individët nuk mund të ankohen në abstrakt lidhur me legjislacionin ose aktet qeveritare të cilat nuk janë aplikuar për ata personalisht, përmes një mase të zbatimit (shih *Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 7525/76, GJEDNJ, vendimi i 22 tetorit 1981. Shih gjithashtu Rastin KI117/11 parashtrues i kërkesës *Ridvan Hoxha kundër Komunës së Prizrenit*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për Papranueshmëri i 18 korrikut 2012).
25. Gjykata përkujton se një ankesë duhet të sillet nga apo në emër të personave që pretendojnë se janë viktimat të shkeljes së dispozitave kushtetuese. Këta persona duhet të jenë në gjendje të tregojnë se janë "prekur drejtpërsëdrejti"

nga masa ndaj të cilës ankohen (shih rastin *Ilhan kundër Turqisë*, kërkesa nr. 22277/93, GJEDNJ, Aktgjykimi, i 27 qershorit 2000).

26. Gjykata konsideron se, siç parashihet me nenin 113.7 dhe nenin 47.1 të Ligjit, parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se një autoritet publik ka shkelur ndonjë nga të drejtat dhe liritë e tij individuale apo të OJQ-ve të garantuara me Kushtetutë.
27. Prandaj, Gjykata e konsideron jo relevante për rastin nëse parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën në emër të tij ose si përfaqësues i OJQ-së. Në të vërtetë, në të dy cilësitë, parashtruesi i kërkesës i mungon *locus standi* në këtë Gjykatë.
28. Si përmbledhje, Gjykata përfundon se parashtruesi i kërkesës nuk është person i autorizuar për të kontestuar në abstrakt kushtetutshmërinë e Urdhëresës së Kryetarit të Komunës së Ferizajt dhe prandaj kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, me nenin 47 (1) të Ligjit dhe me rregullin 36 (3) c) të Rregullores së punës, më 21 tetor 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

